




Pranimar / Dorezuar Primijsen / Prodato Received / Delivery	21-05-2021	viti god year	1
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSTOK	2577/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.278/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.278/2021 të datës 15.04.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Dardania", Blloku 15,nr.13, Komuna e Fushë Kosovës , kundër organit të punësimit/ Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa numër A.nr.278/2021, e datës 15.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës ,sipas akt emërimit me numër Nr.Prot.02/1007/11, të datës 24.03.2017, në pozitën "Asistente administrative". Me datën 31.08.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, ka nxjerr vendimin me numër 11-06-3073, sipas te cilit ankueses i'u është lejuar kompensimi për punën jashtë orarit si koordinatorë në emër të Drejtorit të Përgjithshëm ne projektin "Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë informative sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së", sipas te cilit i njëjti aktivitet shtesë do të fillojë se zbatuari nga data 01.09.2017 e deri në përfundimin e këtij projekti.

Në lidhje me këto përgjegjësi shtesë drejtori i përgjithshëm i ATK-së më datë 31/08/2017 përmes vendimit Z.Q,Nr.11/06/3073 i ka ndryshuar dhe plotësuar akt emërimit ankueses me që rast ka përshkuar detyrat shtesë sa i përket angazhimit shtesë si koordinatorë në

emër të Drejtorit të Përgjithshëm në projektin "Modernizimi i Sistemit të Teknologjisë Informative sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së".

Ankuesja me datën 20.11.2020, përmes e-mailit zyrtar i 'u është drejtuar

në Administratën Tatimore të Kosovës, me kërkesën për pagesën e shtesës në vlerën prej 100 eurove për angazhim si koordinatorë në projektin e IT, për periudhën kohore Maj 2019-Nëntor 2020 të pa paguar nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës. Me datë 25.11.2020, përsëri përmes e-mailit zyrtar i drejtohet Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës, ku thekson se e-maili i mëhershëm është dërguar gabimisht tek zyrtarja jo kompetente në lidhje me këtë kompensim.

Më datë 26/11/2020, nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës i është kthyer përgjigjeje në lidhje me kërkesën e datës 25/11/2020 sa i përket këtij kompensimi shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 20.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administratës Tatimore të Kosovës. Këshilli me datë 28.04.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1800/2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër të protokollit 11-06-3073 i datës 31.08.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit të ankueses me numër 11-06-3073, i datës 31.08.2017; E-maili zyrtar i datës 26.11.2020; E-maili zyrtar i datës 25.11.2020; E-maili zyrtar i datës 20.11.2020; E-maili zyrtar i datës 11.11.2020; E-maili zyrtar i datës 14.10.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.04.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 28.04.2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës; E-maili zyrtar i datës 17.05.2021; Përgjigje në ankesën e datës 26.04.2021; Akt emërimi i ankueses me numër Nr.Prot.02/1007/11 i datës 24.03.2017; Akt emërimi i ankueses i datës 28.12.2018; Lista e pagave për muajin dhjetor të vitit 2017; Lista e pagave për muajin shkurt të vitit 2018; Lista e pagave për muajin mars të vitit 2018; Lista e pagave për muajin prill të vitit 2018; Lista e pagave për muajin qershor të vitit 2018; Lista e pagave për muajin dhjetor të vitit 2018; Lista e pagave për muajin prill të vitit 2019; Lista e pagave për muajin maj të vitit 2019; Lista e pagave për muajin qershor të vitit 2019; Lista e pagave për muajin shtator të vitit 2020; Lista e pagave për muajin tetor të vitit 2020; Raporti i analizës për përfituesit nga Ministria e Financave për vitin fiskal 2021; Shkrese zyrtare e datës 22.04.2021; E-maili zyrtar i datës 27.04.2021; E-maili zyrtar i datës 27.04.2021; E-maili zyrtar i datës 14.05.2021; Vendim me numër Nr.Prot.09-06-2467 i datës 17.08.2020; Vendim me numër Nr.Prot.09-06-1650; Vendim i datës 15.01.2020; Vendim me numër Nr.Prot.09-06-703 i datës 10.02.2021; Vendim me numër Nr.Prot.09-06-704 i datës 10.02.2021.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se: ankuesja kërkesën përmes e-mailit zyrtar lidhur me kompensimin e shtesës për angazhim në pozitën "Koordinatorë në projektin e IT"e, në Administratën Tatimore të Kosovës, e ka parashtruar me datën 20.11.2020, tek zyrtarja ndërsa më datë 25.11.2020, përsëri përmes e-mailit zyrtar i drejtohet Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës, ku thekson se e-maili i mëhershëm është dërguar gabimisht tek zyrtarja jo kompetente në lidhje me këtë kompensim ndërsa. Në lidhje me këtë kërkesë më datë 26/11/2020, nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës i është kthyer përgjigjeje në lidhje me kërkesën e datës 25/11/2020 sa i përket këtij kompensimi shtesë.


Ankuesja duke u ndërlidhur me përgjigjen e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës përmes E-mailit të datës 26/11/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me datë 15.04.2021, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: 1. "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", dhe 4 "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", andaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave mbi bazë të provave që kemi administruar në lidhje me këtë ankesë që janë dorëzuar nga dy palët konstatohet se ankesa në kuptim të përmbajtjes së nenit 127 paragrafi 1 dhe 4, të LPPA-së të specifikuar më lartë dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstaton se ankesa e ankueses është e pa lejuar.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.278/2021, datë 21/05/2021

Ardita PERÇUKU-SHYTI


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



